

Muela Ibrahimimi është një profesioniste e motivuar, me një prapavijë të fortë ekonomike dhe me një shpirt ekipor. Ajo është Udhëheqëse e Departamentit për Politika dhe Analiza Ekonomike në Odën Ekonomike të Kosovës, autore e studimeve të shumta ekonomike, hulumtimeve të tregut dhe koordinatore në disa projekte vendore dhe ndërkombëtare. Ajo ka kontribuar në kryerjen e shumë hulumtimeve të tregut me fokus kryesor ndikimin e transformimit digjital në modelin biznesor të NVM-ve dhe në identifikimin e potencialit të tyre për rritje përmes transformimit digjital.